



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L– 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 5.2 dhe nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2019, merr këtë

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONINIT TË AKSIONARËVE TË
NDËRMARRJES PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

I

MIRATOHET Vendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale të Komunës së Prishtinës “Kuzhina Qendrore”, SHA, Prishtinë.

II

Anëtarë të komisionit të cekura në pikën I të këtij vendimi janë:

1. **Fiknete Bejta**, anëtare,
2. **Mustafë Krasniqi**, anëtar.

III

Komisioni komunal i aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin e ndërmarrjeve publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/04-275305/19, më 08.11.2019



KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta